



## **VENDIMI DHE GJETJET**

**Data e miratimit: 11 dhjetor 2019**

**Numri i lëndës: 2016-14**

**Milan Ađančić**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, i mbledhur më 11 dhjetor 2019, me përbërjen si në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare  
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:  
Z. Ronald HOOGHMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP, të datës 4 shkurt 2008, Konceptin për llogaridhënien e EULEX-it për themelimin e Panelit për shqyrtimin e të drejtave të njeriut dhe të Rregullores së punës së Panelit, të datës 29 tetor 2009, të ndryshuar më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimeve, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa e kësaj lënde është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Përmes letrës së datës 1 korrik 2016, Paneli e informoi Misionin për regjistrimin e kësaj lënde në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli kërkoi nga ky ankues dhe nga ankuesit e tjerë informata shtesë në lidhje me ankesat e tyre. Ankuesit fillimisht u përgjigjën përmes përfaqësuesit

për familjet serbe nga Qendra Burimore për Personat e Zhdukur (QBPZh), OJQ në Prishtinë, duke thënë se ata nuk kishin informata të tjera në lidhje me ato raste.

4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli dërgoi dy kërkesa të tjera për informata shtesë përmes përfaqësuesit të QBPZh-së.
5. Më 20 tetor 2017, Paneli pranoi një përgjigje përmes përfaqësuesit të QBPZh-së me informata shtesë në lidhje me dy raste, përfshirë për rastin në fjalë.
6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i dërgoi deklaratën me fakte dhe pyetje Shefes së Misionit (ShM), EULEX-i Kosovë, dhe e ftoi atë që të jepte përgjigje dhe vërejtje më shkrim mbi ankesat jo më vonë se 26 janar 2018.
7. Përmes letër së datës 19 janar 2019, Misionit prapë iu kërkua përgjigje ndaj pyetjeve deri më datën 16 shkurt 2019.
8. Vërejtjet nga ShM-ja erdhën më 12 mars 2019.
9. Më 15 mars 2019, letra e ShM-së u dërgua për informim tek ankuesi, të cilit iu dha kohë deri më 15 prill 2019 për parashtrime të tjera ndaj asaj letre.
10. Më 19 qershor 2019, Paneli dha vendimin mbi pranueshmërinë së kësaj lënde, duke e shpallur ankesën e pranueshme në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej në tekst “Konventa Evropiane” apo “Konventa”) (<https://hrrp.eu/docs/decisions/2019-06-19%20Admissibility%20Decision%202016-14.pdf>).
11. Gjithashtu, në vendimin mbi pranueshmërinë, Paneli ftoi palët që t'i shqyrtonin këto pyetje:

#### I. PËR SHEFEN E MISIONIT:

- i. A u janë dhënë ndonjëherë Prokurorëve të EULEX-it dosjet që i përkasin këtij rasti të cilat janë në posedim të Institutit të Mjekësisë Ligjore? Nëse jo, cila është arsyeja?
- ii. Çfarë hapa (nëse është ndërmarrë ndonjë) janë ndërmarrë nga Misioni për të siguruar bashkërendim mes organeve të tij të ndryshme për centralizimin dhe ndarjen e informatave rreth hetimeve në proces për veprat penale të rënda, përfshirë për rastet e “zhdukjeve me dhunë”?
- iii. A ka Misioni kompetencë të monitorojë këtë rast pa qenë të iniciuara hetimet nga autoritetet e vendit? Nëse jo, çfarë është i autorizuar Misioni të bëjë nëse, sipas pikëpamjes së tij, autoritetet e vendit nuk i përmbushin obligimet e tyre – procedurale – sipas neneve 2 ose 3 të Konventës?
- iv. Ju lutem të na siguroni një kopje të letrës së datës 11 qershor 2018. A ka vepruar ngjashëm Misioni për secilin ras: për të siguruar që të afërmit e personave të zhdukur të njoftohen për hecjen poshtë të rastit kur një gjë e tillë ka ndodhur gjatë mandatit të EULEX-it, apo a është ky veprim i veçantë për këtë rast?
- v. Në parashtrimet e veta, Misioni ka dhënë indikacione se ‘është menduar si e pamundshme që hetime të tjera nga policia do të siguronin informata

shtesë' (shih vendimin mbi pranueshmërinë, par. 31). Cilët ishin faktorët apo konsiderimet që kanë shpjerë në atë konkluzion? Kush e ka dhënë atë konkluzion dhe kur?

- vi. Në parashtrimet e veta (të përmbledhura në vendimin mbi pranueshmërinë, par. 26), Misioni tregon se si rezultat i rikonfigurimit të NjHKL në vitin 2014, kapaciteti i inteligjencës dhe i hulumtimeve të Misionit është fshirë. Kush e mori atë vendim? Në bazë të çfarë faktorësh dhe konsiderimesh?

## **II. PËR ANKUESIN:**

- i. Çfarë kontakti keni pasur me EULEX-in gjatë periudhës 2008-2014 në lidhje me këtë rast? Në veçanti, të çfarë natyre dhe shkalle kanë qenë kontaktet tuaja me Institutin Forenzik të EULEX-it?
- ii. Ju lutemi përshkruani ndikimin – financiar, personal dhe emocional – që zhdukja e familjarit tuaj ka pasur tek ju.

## **II. PËRBËRJA E PANELIT**

12. Pas dorëheqjes së një prej anëtarëve të përhershëm të tij, ai është zëvendësuar nga znj. Autio me emërimin e saj në Panel sipas Rregulës 14 të rregullores së punës së Panelit. Znj. Autio është njoftuar plotësisht për tërë lëndën e rastit, përfshirë sa i përket pranueshmërisë, dhe ajo është plotësisht në pozitë që të merr pjesë në shqyrtimin e kësaj lënde.

## **III. FAKTET**

13. Faktet e paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidher si në vazhdim.
14. Më 22 qershor 1998, Dušan Ađančić, babai i ankuesit Milan Ađančić, është kidnapuar rrugës për në punë afër minierës së Bellaçevcit, komuna e Fushë Kosovës. Atë ditë ai u zhduk në rrethana të panjohura dhe atë më nuk e ka shtë parë njeri.
15. Ankuesi dhe familja e tij e kishin njoftuar Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë, KNKQ në Serbi si dhe UNMIK-un dhe, rrjedhimisht, Misionin EULEX-i Kosovë.

## **IV. PARASHTRESAT E PALËVE**

### **Ankuesi**

16. Ankuesi pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij EULEX-i Kosovë do të duhej të kishte hetuar zhdukjen e babait të tij dhe në mënyrë fajësuese nuk e ka bërë hetimin, duke shkëlur kështu të drejtat themelore të tij dhe të babait të tij.

### **Shefja e Misionit ("ShM")**

17. Parashtrësat e Misionit sa i përket meritave të këtij rasti u dërguan në Panel më 19 shtator 2019.

18. Si çështje paraprake, Misioni i korigjoi parashtrësit e veta të mëhershme sa i përket sugjerimit të tij të gabuar se nuk kishte pasur indikacione se Njësia e EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjHKL) kishte marrë dosjen e Njesisë së UNMIK-ut për personat e zhdukur. Pas verifikimeve të mëtejme, tani duket se e kishte marrë.
19. Si përgjigje ndaj pyetjes së Panelit nëse dosja në posedim të Institutit të Mjekësisë Ligjore është ndarë me Prokurorët e EULEX-it, ushtruesi i detyrës së shefit të Misionit parashtrësi se do të dukej se prokurorët e Misionit nuk kanë qenë në dijeni për praninë e dosjeve në posedim të Institutit të Mjekësisë Ligjore në lidhje me këtë rast dhe duhet të kenë supozuar se ata kanë pasur në posedim të gjitha të dhënat përkatëse. 'Do të dukej', Misioni tha, 'se, në atë kohë, njësitë e ndryshme të EULEX-it nuk kanë qenë në dijeni se dokumente që i përkasin ngjarjeve dhe/apo individëve të njëjtë ishin ndarë nëpër dosje të ndryshme të rasteve dhe ishin regjistruar me numra të ndryshëm të lëndëve.'
20. Paneli pastaj pyeti
- 'Çfarë hapa (nëse është ndërmarrë ndonjë) janë ndërmarrë nga Misioni për të siguruar bashkërendim mes organeve të tij të ndryshme për centralizimin dhe dhënien e informatave që i përkasin hetimeve që ishin në proces për veprat penale të rënda, përfshirë për rastet e "zhdukjeve me dhunë"?'.
21. ShM-ja dha këtë përgjigje:
- 'Si praktikë e përgjithshme, çdo herë që NjHKL dhe prokurorët e EULEX-it në PSRK hetonin raste, ata kontaktonin me njësi të tjera për të përcaktuar nëse ekzistonin informata shtesë. Kjo praktikë mund të jetë zbatuar në një shkallë më të ulët në fazën fillestare të Misionit.'
22. Misioni nuk ka kërkuar që të shqyrtojë se përse kjo praktikë e 'përgjithshme' nuk është zbatuar në rastin në fjalë. Misioni shtoi se do të dukej se në semestrin e parë, dhe si rezultat i numrit të lartë të rasteve që vinin, shqyrtimi dhe vlerësimi i dosjeve të UNMIK-ut 'kryesisht është bazuar (...) në atë që veçse ekzistonte në dosjet e rasteve'.
23. Ndaj pyetjes se nëse Misioni është kompetent për ta monitoruar këtë rast edhe pa iniciimin e hetimeve nga ana e autoriteteve të vendit, ShM-ja nuk e ka shqyrtuar qartazi pyetjen e Panelit dhe nuk ka specifikuar nëse ai do të ishte në pozitë ta monitoronte këtë rast. Në vend të asaj, dha një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së funksionit të monitorimit dhe të mandatit. Ajo specifikoi, megjithatë, se raste të përzgjedhura monitorohen apo mund të monitorohen 'nga faza e hetimeve deri tek ekzekutimi i dënimit'. Do të dukej se kompetenca e Misionit për monitorim në parim mbulon tërë zinxhirin e sistemit të drejtësisë penale, përkatësisht në nivel të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit:
- Njësia e EULEX-it për Monitorimin e Rasteve bënë vlerësimin e funksionimit të gjyqësorit të Kosovës për nga aspekti i përputhshmërisë procedurale, juridike dhe i të drejtave të njeriut. Vlerësimi bëhet përmes monitorimit të thuktë sistematik dhe tematik të rasteve të përzgjedhura penale dhe civile, përfshirë rastet e profilit të lartë dhe rastet që më parë janë trajtuar nga EULEX-i. Misioni bënë monitorime të tërë zinxhirit të sistemit të drejtësisë penale, përkatësisht në nivel të policisë, prokurorisë dhe të gjyqësorit. <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,1069>
24. Paneli më tej pyeti rreth pohimit të Misionit se ai e vlerësonte si të pamundshme që hetimet e mëtejme do të siguronin informata të mjaftueshme për çuarjen përpara të çështjes. Siç është bërë në rastin 2016-09, përgjigja e Misionit për atë pikë është e shkurtër sa i përket specifikave. Ajo sugjeroi se Misioni kupton se ky konkluzion është

arritur në mënyrë të pavarur nga prokurori i PSRK-së në bazë të vlerësimit të dhënë nga NjHKL-ja:

'Ky konkluzion është arritur në kontekstin e përgjithshëm dhe nën rrethanat e përgjithshme të shpjeguara në faqet 2-9 të përgjigjeve të EULEX-it të datës 12 mars 2019 në lidhje me rastin. Është legjitime të supozohet se nëse numri i rasteve dhe i dokumenteve të dorëzuara nga UNMIK-u do të kishte qenë dukshëm më i ulët dhe ato do të kishin qenë të organizuara siç duhet, prokurori do të mund të kishte zgjedhur hapjen e hetimeve, në vend të hedhjes poshtë të kallëzimit penal në bazë të informatave që kanë qenë në dosjer e NjHRP-së.'

25. Sa i përket heqjes së kapacitetit për inteligjencë dhe hulumtime të Misionit në vitin 2014, Misioni deklaroi se 'është e mundshme se ky vendim ishte marrë (nga vendet anëtare të BE) duke pasur parasysh ndryshimet e mandatit të EULEX-it në vitin 2014'.
26. Ushtruesi i detyrës së ShM-së më tej theksoi se vlerësimi i përgjegjësisë së Misionit sipas nenit 2 (dega procedurale) dhe nenit 3 të Konventës Evropiane 'nuk mund të shpërfillë kontekstin dhe rrethanat në të cilat Misioni është ftuar të zbatojë mandatin e vet'. Ai po ashtu nënvizoi një sërë sfidash të hasura nga Misioni në atë kohë, përfshirë numrin e rasteve për shqyrtim, gjendjen e dosjeve që ishin marrë nga UNMIK-u, kufizimet e burimeve, afatin kohor të mandatit të tij dhe hapat e ndërmarrë nga Misioni për organizimin e regjistrave që ishin marrë nga UNMIK-u. Misioni i bëra parashtresat në vijim të cilat ishin shumë relevante për rastin në fjalë, e që Paneli i prezanton fjalë për fjalë:

'Duket se dy vendime kanë ndikuar në qasjen fillestare të njërive policore dhe prokuroriale të Misionit: në njërin anë prioritizimi i shqyrtimit dhe ekzaminimit të rreth 1200 dosjeve të rasteve që nga UNMIK-u ishin emërtuar si 'dosje të krimeve të luftës' para të atyre që janë emërtuar si 'dosjet e personave të zhdukur'; dhe në anën tjetër, identifikimi i shpejtë i atyre rasteve të krimeve të luftës që janë dukur më premtuese për nga aspekti i rezultateve të hetimeve. Kjo ka quar në hedhjen poshtë të kallëzimeve penale për krimet të cilët nuk ka mundur të identifikohet asnjë i dyshuar specifik në bazë të informatave që gjendeshin në dosje dhe aty ky është vlerësuar si e pamundshme që hetimet e mëtejme nga policia mund të japin informata të mjaftueshme. Megjithatë, fakti që Misioni nuk ka hetuar zhdukjen e Dušan Adančić nuk ka pasur asnjë domethënie sa i përket përpjekjeve për të tentuar dhe gjetur vendndodhjen apo mbetjet mortore e tij nga stafi i Misionit në IML. Si fakt, ndërsa rasti penal ishte hedhur poshtë në vitin 2009 nga ana e prokurorit të EULEX-it në PSRK, rasti në IML ka vazhduar paralelisht dhe nuk është mbyllur. Gjatë dhjetë viteve të kaluara, EULEX-i me kapacitetet e veta prej ekspertëve në IML ka ndërmarrë përpjekje madrore për gjetjen e Dušan Adančić dhe të tetë personave të tjerë të zhdukur. Këto përpjekje kanë filluar në vitin 2008, kur ishin kryer punimet e para të gërmimeve për një gërmim më të madh (hartimi i një strategjie, sigurimi i fondeve nga donatorë ndërkombëtarë dhe sigurimi i bashkëpunimit të institucioneve të Kosovës). Siç është cekur tashmë në përgjigjet dhe vërejtjet e Misionit të datës 12 mars 2019, këto përpjekje arritën kulmin në gërmimet e gjata gjashtëmujore të kryera mes viteve 2011 dhe 2012 në Zhilivodë, në një sipërfaqe prej rreth 2000 metra katrorë dhe në një thellësi deri në 25 metra. Fatkeqësisht asnjë mbetje mortore nuk është gjetur. Po të ishin gjetur mbetje mortore, është legjitime të supozohet se hetimet penale me siguri se do të ishin filluar.

27. Misioni po ashtu specifikoi se sipas mandatit aktual të rikonfiguruar, Misioni vazhdon të ketë kapacitet ekzekutiv për mbështetjen e IML-së së Kosovës:

'Nëse dalin informata të reja të besueshme. Misioni qëndron i gatshëm t'i mbështesë institucionet e Kosovës në çfarëdo operacioni shtesë për gjetjen e z. Dušan Ađančić dhe të të zhdukurve të tjerë'.

28. Misioni shtoi vërejtjet në vazhdim:

'Misioni pranon se njësitë e veta policore dhe prokuroriale kanë mundur dhe është dashur të jenë më të kujdesshme me rastin e trajtimit të dosjes së NjHRP-së. Në përgjithësi, Misioni është dashur të bëjë më shumë përpjekje komunikuese për t'i mbajtur viktimat dhe publikun e gjerë të informuar rreth strategjive dhe qasjeve të tij, me qëllim të menaxhimit të pritshmërive në mënyrë më adekuate dhe për të qenë më transparent. Megjithatë, në rastin aktual dhe me marrjen parasysht të pengesave themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit janë shkelur, dhe duke i pasur parasysht të gjitha që janë cekur më lartë, pohon se ai ka bërë atë që ka qenë në mënyrë të arsyeshme e mundshme për të zbardhur fatin e Dušan Ađančić.'

29. Përfundimisht, më 6 nëntor 2019, një anëtar i Sekretariatit të Panelit mori qasje në letrën e Misionit të datës 5 nëntor 2018 e cila i ishte bashkëngjitur dorëzimit të dosjes së këtij rasti tek autoritetet e vendit. Një prej këtyre dokumenteve, Vendimi i datës 20 korrik 2009 për hedhjen poshtë të kallëzimit penal, bëri të ditur se kallëzimi penal për hetimin e zhdukjes së familjarit të ankuesit ishte hedhur poshtë nga PSRK-ja mbi këto baza:

'Dosja e rastit nuk përmban elemente që mund të qojnë në identifikimin e ndonjë të dyshuari të mundshëm.

[...]

Nga kallëzimi penal është e qartë se nuk ka dyshime të arsyeshme kundër ndonjë të dyshuari specifik për veprën penale të përshkruar më lartë. Përveç kësaj, prokurori beson se nuk ka mundësi të arsyeshme që hetimet e mëtejme nga policia do të mund të sigurojnë informata të mjaftueshme.'

30. Paneli po ashtu pati mundësinë që në atë kontekst të shqyrtojë letrën e dorëzimit të cilën EULEX-i e kishte bashkëngjitur në atë dosje me rastin e transferimit të saj tek autoritetet e vendit më 5 nëntor 2018. Në letrë thuhej se pavarësisht hedhjes poshtë të rastit më 20 korrik 2009,

'Megjithatë, unë ftoj zyrën tuaj që pas pranimit të bëjë shqyrtimin e vet të dosjes së rastit, dhe të kontaktojë NjHKL-në për të verifikuar nëse ata janë ende në posedim të ndonjë materiali tjetër që i përket këtij rasti.'

#### **Parashtresat e tjera nga ankuesi**

31. Parashtresa të tjera nga ankuesi nuk kanë ardhur.

### **V. SHQYRTIMET**

#### **"Zhdukja me forcë" si shkelje e rëndë e të drejtave themelore të viktimave**

32. Praktika e zhdukjes me forcë është një nga shkeljet më flagrante të të drejtave të njeriut. Aty nuk përfshihet shkelja e vetëm një të drejte, por e shumë të drejtave, duke përfshirë në shumë raste, shkeljen e të drejtës për të vërtetën, të drejtës e njohjes si person para ligjit, të drejtën për liri dhe sigurinë e personit dhe të drejtën për të mos iu nënshtruar

torturës dhe trajtimit ose dënimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, të drejtën për një zgjidhje efektive dhe një veprim i tillë cenon ose përbën kërcënim të rëndë për të drejtën për jetë. *Shih, p.sh., Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 33; S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 Shtator 2019, par. 61; Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me forcë (A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992).*

33. Çka është në veçanti e rëndësishme në atë kontekst është e drejta e ankuesit për të vërtetën, d.m.th. e drejta e viktimave për të ditur se çfarë ka ndodhur me të afërmit e tyre dhe rrethanat në të cilat ata janë zhdukur. *Shih, në përgjithësi, S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 62; Desanka dhe Zoran Stanisic kundër EULEX-it, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 67; Shih edhe El-Masri v Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Aplikacioni nr. 39630/09, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 12 dhjetor 2012, par. 191-193; Orhan kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 25656/94, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 18 qershor 2002, par. 358; Imakayeva kundër Rusisë, Aplikacioni nr. 7615/02, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 9 nëntor 2006, para 164; Velásquez Rodríguez kundër Hondurasit, aktgjykimi i datës 29 korrik 1988, par. 181; Heliodoro Portugal kundër Panamasë, aktgjykimi i datës 12 gusht 2008, par. 244; Anzualdo Castro kundër Perusë, aktgjykimi i datës 22 shtator 2009, par. 116-118; Komenti i përgjithshëm për të drejtën për të vërtetën në lidhje me zhdukjet me forcë, Raporti i Grupit Punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme, 2010, në veçanti, par. 1, Dokumenti A/HRC/16/48; Lista e parimeve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut përmes veprimeve për të luftuar mosndëshkueshmërinë (E/CN.4/2005/102/Add.1), në veçanti, parimet 2-4; dhe, gjithashtu, Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë, e miratuar më 20 dhjetor 2006, në veçanti, Preambula dhe neni 24 (2); dhe, për një ilustrim, lënda Gudiel Alvarez dhe të tjerët ("Diario Militar") kundër Guatemalës, Aktgjykimi i 20.11.2012; Meritat, reparacionet dhe shpenzimet, par. 301 (dhe referencat e cituara).*
34. Për pothuajse dy dekada, ankuesi ka jetuar me pasiguri rreth fatit të babait të tij, se çka i kishte ndodhur dhe në çfarë rrethanash ai ishte zhdukur. Vuajtjet psikologjike nga kjo janë tejet të rënda. Ato janë gjithmonë të pranishme. *Shih edhe S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 63; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 to 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 78; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, par. 35 dhe 42. Shih edhe, në kontekstin e nenit 3, GjEDNj, Kurt kundër Turqisë, aktgjykimi i datës 25 maj 1998, Raportet e aktgjykimeve dhe të vendimeve 1998- III, par.130-34; Khadzhiyev dhe të tjerët kundër Rusisë, Aplikacioni nr. 3013/04, aktgjykimi i datës 6 nëntor 2008, par. 120-121; Timurtas kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 23531/94, Aktgjykimi i datës 13 qershor 2000, par. 95; Rezoluta nr. 828 e vitit 1984, paragrafi 3 (Asambleja parlamentare e Këshillit të Evropës); dhe Komenti i përgjithshëm për nenin 17 të Deklaratës, Raporti i grupit punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme 2000. Dokumenti E/CN.4/2001/68 (referimi dhe komentimi për nenin 17(1) të Deklaratës për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë).*
35. Natyra e vazhdueshme e shkeljes së të drejtave të përfshira në këtë praktikë e shpjegon se detyra e autoriteteve kompetente për hetimin e këtyre rasteve është obligim urgjent dhe i rëndësishëm i cili mund të lihet mënjanë apo vonohet vetëm në rrethanat më të kufizuarat. *Shih S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 64.*
36. Kur është fjala për hetimin e rasteve të zhdukjeve me forcë, hetimet duhet të fillohen sa më parë që është e mundur dhe vonesat duhet të shmangen sa më shumë që është e

mundur. Kjo jo vetëm për shkak të efektit të pasigurisë tek familjarët e mbijetuar, por edhe për shkak se provat do të zhduken apo të humben dhe kujtesa do të zbehet. Vonesat e hetimeve kështu do të kenë ndikim negativ tek mundësia që hetimet të gjejnë rrethanat në të cilat personi është zhdukur dhe që fajtorët të sillen para drejtësisë. Për ilustrime të aplikimit të kësaj garancie në kontekste të ndryshme, shih në përgjithësi: *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 65; *Gürtekin dhe të tjerët kundër Qipros*, Vendimi i GjEDNj-së për mospranueshmërinë i datës 11 mars 2014; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretëria e Bashkuar [GC]*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011; *Jaloud kundër Holandës [GC]*, Aplikacioni nr. 47708/08, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 20 nëntor 2011; *Jelić kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 57856/11, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 12 qershor 2014; *B. dhe të tjerët kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 71593/11, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 18 qershor 2015; *Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, Aplikacioni nr. 4704/04, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 15 shkurt 2011; *Lejla Fazlić dhe të tjerët kundër Bosnjë dhe Hercegovinës dhe 4 të tjerët*, Aplikacionet nr. 66758/09, 66762/09, 7965/10, 9149/10 dhe 12451/10, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 3 qershor 2014; *Mujkanović dhe të tjerët kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, Aplikacionet nr. 47063/08 e tutje, Vendimi i GjEDNj-së për mospranueshmërinë i datës 3 qershor 2014; *Nježić dhe Štimac kundër Kroacisë*, Aplikacioni nr. 29823/13, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 9 prill 2015.

### **Detyrat dhe obligimet e autoriteteve në lidhje me aktet e zhdukjeve me forcë**

37. Veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it përbëjnë pjesë të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganës. Si të tillë, ata hyjnë në fushëveprimin e mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K deri T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 43; *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, par. 23; *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, par. 35). Ky është rasti nëse veprimet themelore në fjalë përbejnë veprim pozitiv apo dështim i fajshëm. Shih *Krlić kundër EULEX-it*, 26 gusht 2014, par. 25; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 48.
38. Paneli tashmë ka pasur rastin të potencojë se Misioni EULEX nuk është shtet dhe se mundësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritet prej një shteti (shih vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 në 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50, *K deri T kundër EULEX-it*, cituar më lartë, paragrafi 53, shih edhe vendimin e Panelit Këshillëdhënës të UNMIK për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) në rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 Shtator 2019, par. 49).
39. Pritshmëritë e vëna mbi mundësinë e EULEX-it për hetimin dhe zgjidhjen e rasteve penale të ndërlikuara duhet të jenë realiste dhe të mos i vënë EULEX-it obligime joproporcionale të cilat mandati dhe burimet e tij në mënyrë të arsyeshme nuk mund të priten të përmbushin (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 43 dhe 45, dhe referimet e tij te: vendimi i Panelit për *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, par. 50; *K deri T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 53; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, par. 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 72-74; shih edhe vendimin e PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35 dhe par. 70-71).
40. Andaj, është e paraparë që Paneli të shqyrtojë nëse ka pasur pengesa konkrete dhe të vërteta të cilat mund të kenë rrezikuar kapacitetin e EULEX-it për të kryer hetime të menjëhershme dhe efektive për ndonjë rast. Ky vlerësim nuk ka për qëllim të arsyetojë



mangësitë operacionale që nuk janë të lidhura me sfida konkrete dhe të demonstrueshme. *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 44; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 50.

41. Në çdo rast, në veçanti në rastet e këtij serioziteti, autoritetet hetimore janë të parapara që të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi të arsyeshme dhe që të investojnë burime në proporcion me nevojën dhe mundësinë për zgjidhjen e rastit. Ndonëse nuk mund të pritet që autoriteti hetimor t'i zgjidhë të gjitha rastet që paraqiten para tij, nga ai pritet që të veprojë me një kujdes, shpejtësi dhe efektshmëri që do të reflektonte peshën e çështjes që është nën hetim (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 46 dhe 59; shih edhe *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, par. 191; *Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, par. 63; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 54).
42. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar një sërë parimesh të përgjithshme të cilat janë udhëzime se çka kërkon dhe pret e drejta për të drejtat e njeriut nga hetimet efektive për pretendimet e shkeljes së të drejtave nga neni 2 i Konventës Evropiane (*Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 24014/05, Aktgjykimi, 14 prill 2015 (salla e madhe), par. 169ff):

“169. ... Hetimet duhet të jenë, *inter alia*, të plota, të paanshme dhe të kryera me kujdes (shih *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 shtator 1995, §§ 161-163, seria A nr. 324).

170. Forma e hetimit që ky obligim e kërkon dallon varësisht prej natyrës së cenimit së jetës: ndonëse hetimi penal është në përgjithësi i nevojshëm kur vdekja shkaktohet me qëllim, procedurat civile apo edhe disiplinore mund të plotësojnë këtë kriter kur vdekja ndodh si rezultat i neglizhencës (shih, *inter alia*, *Calvelli dhe Ciglio kundër Italisë*, cituar më lartë, § 51; *Mastromatteo kundër Italisë* [GC], nr. [37703/97](#), § 90, KEDNJ 2002-VIII; dhe *Vo kundër Francës*, cituar më lartë, § 90).

171. Duke i kërkuar shtetit që të ndërmerri hapa të duhur për ruajtjen e jetës së atyre nën juridiksionin e tij, neni 2 shqipton detyrim mbi atë shtet që të sigurojë të drejtën për jetë përmes caktimit të dispozitave të të drejtës penale për pengimin e kryerjes së veprave kundër personit, të mbështetura me makinerinë e zbatimit të ligjit për parandalimin, ndalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve të atyre dispozitave. Ky obligim kërkon me nënkuptim se duhet të ekzistojë njëfarë forme e hetimeve zyrtare efektive kur ka arsye për të besuar se ndonjë individ ka pësuar lëndime që ia kërcënojnë jetën në rrethana të dyshimta, edhe në rastet kur i dyshuari për kryerjen e sulmit fatal nuk është agjent i shtetit (shih *Menson kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendimi), nr. [47916/99](#), KEDNJ 2003-V; *Pereira Henriques kundër Luksemburgut*, nr. [60255/00](#), § 56, 9 maj 2006; dhe *Yotova kundër Bullgarisë*, nr. [43606/04](#), § 68, 23 tetor 2012).

172. Në mënyrë që hetimi të jetë ‘efektiv’ siç duhet kuptuar kjo shprehje në kontekstin e nenit 2 të Konventës, hetimi duhet së pari të jetë adekuat (shih *Ramsahai dhe të tjerët kundër Holandës* [GC], nr. [52391/99](#), § 324, KEDNJ 2007-II). Pra, ai duhet të jep mundësinë që të shpije në gjetjen e fakteve dhe, kur është e mundur, në identifikimin dhe dënimin e përgjegjësve.

173. Obligimi për zhvillimin e hetimit efektiv nuk është obligim i rezultatit por i mjeteve: autoritetet duhet t'i ndërmarrin masat e arsyeshme që i kanë në dispozicion për të gjetur provat që kanë të bëjnë me rastin në fjalë (shih *Jaloud*

kundër Holandës [GC], nr. [47708/08](#), § 186, KEDNJ 2014; dhe *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* [GC], nr. [43577/98](#) dhe [43579/98](#), § 160, KEDNJ 2005-VII).

174. Autoritetet duhet të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm që ato mundën për të gjetur prova në lidhje me rastin, përfshirë, *inter alia*, deklarata nga dëshmitarët okularë, prova forenzike dhe, kur është e mundur, autopsi që jep të dhëna të plota dhe të sakta të lëndimeve dhe një analizë objektive të konstatimeve klinike, përfshirë shkaktarin e vdekjes. Çdo mangësi të hetimit që e rrezikon mundësinë e tyre për të gjetur shkaktarin e vdekjes apo personin përgjegjës do të rrezikojë që ky standard të mos përmbushet (shih *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë* [GC], nr. [23458/02](#), § 301, KEDNJ 2011).

175. Në veçanti, konkluzionet që dalin nga hetimi duhet të bazohen në analiza të plota, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve relevantë. Mosndjekja e një vije të qartë të hulumtimeve rrezikon në masë vendimtare mundësinë e hetimit për të zbuluar rrethanat e rastit dhe, aty ku është e mundur, identifikimin e përgjegjësve (shih *Kolevi kundër Bullgarisë*, nr. [1108/02](#), § 201, 5 nëntor 2009).

176. Megjithatë, natyra dhe shkalla e inspektimit që e përmbushë pragun minimal të efektivitetit të hetimit varen nga rrethanat e rastit të caktuar. Është e pamundur që llojlloshmëria e situatave që mund të ndodhin të reduktohet me një listë kontrolluese të thjeshtë të veprimeve të hetimit apo me kritere të tjera të thjeshtësuara (shih *Tanrikulu kundër Turqisë* [GC], nr. [23763/94](#), §§ 101-110, KEDNJ 1999-IV; dhe *Velikova kundër Bullgarisë*, nr. [41488/98](#), § 80, KEDNJ 2000-VI).

177. Më tej, personat përgjegjës për hetimet duhet të jenë të pavarur nga kushdo që është i implikuar apo që ka gjasa të jetë i implikuar në incidentet. Kjo nënkupton mungesën e lidhjes hierarkike apo institucionale por edhe pavarësinë praktike (shih *Anguelova kundër Bullgarisë*, nr. [38361/97](#), § 138, KEDNJ 2002-IV).

178. Kriteri i shpejtësisë dhe i përshpejtimit të arsyeshëm është i nënkuptueshëm në këtë kontekst (shih *Al-Skeini dhe të tjerët*, cituar më lartë, § 167).

179. Përveç kësaj, hetimi duhet të jetë i qasshëm për familjarët e viktimës në masën e nevojshme për ruajtjen e interesave të tyre legjitime. Gjithashtu duhet të ekzistojë elementi i mjaftueshëm i inspektimit publik të hetimit, shkalla e së cilit mund të ndryshojë prej rastit në rast (shih *Hugh Jordan kundër Mbretëria e Bashkuar*, nr. [24746/94](#), § 109, KEDNJ 2001-III). Qasja e kërkuar e qytetarëve apo e të afërmeve të viktimës, megjithatë, mund të parashihet në faza të tjera të procedurës (shih, në mesin e autoriteteve të tjera, *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lartë, § 304; dhe *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. [28883/95](#), § 129, KEDNJ 2001-III).

180. Neni 2 nuk shqipton detyrim mbi autoritetet hetimore që ato të përmbushin secilën kërkesë për ndonjë masë të caktuar hetimore të bërë nga ndonjë familjar përgjatë zhvillimit të hetimeve (shih *Ramsahai dhe të tjerët*, cituar më lartë, § 348; dhe *Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë*, nr. [64301/01](#), § 113, 1 dhjetor 2009).

181. Pyetja se nëse ndonjë hetim ka qenë mjaftueshëm efektiv duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe duke i pasur parasysh realitetet praktike të punës hetimore (shih *Dobriyeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. [18407/10](#), § 72, 19 dhjetor 2013; dhe *Qendra për burime juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [GC], nr. [47848/08](#), § 147, 17 korrik 2014)."

43. Gjykata Evropiane ka theksuar një element tjetër të rëndësishëm të hetimeve në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, përkatësisht, nevojën që autoritetet hetimore të

kërkojnë ndihmën dhe bashkëpunimin e autoriteteve të tjera nëse dhe kurdo që këto të fundit mund të kenë në posedim informata dhe/apo burime relevante për përpjekjet e tyre për zhvillimin e hetimeve efektive. Shih, në përgjithësi, *lëndën Güzelyurtlu dhe të tjerët kundër Qipros dhe Turqisë*, Aplikacioni nr. 36925/07, *Aktgjykimi*, 29 janar 2019, par. 229 dhe 232-233:

'229. Hulumtimi i sipërm i praktikës gjyqësore tregon se në shumicën e rasteve në të cilat Gjykata ka shqyrtuar mungesën e bashkëpunimit ose mos dërgimin e kërkesës për bashkëpunim mes shteteve në rastet ndërkombëtare, ajo e ka bërë atë gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së përgjithshme nga ana e shtetit përkatës me obligimin e tij procedural për hetime sipas nenit 2. Në këto raste mungesa e bashkëpunimit ka qenë vetëm një aspekt në mesin e të tjerëve gjatë shqyrtimit që gjykata ka bërë sa i përket efektivitetit të hetimeve të zhvilluara nga shteti përkatës, në përgjithësi, mos kërkitimi i bashkëpunimit nga një shtet tjetër (për shembull, Qipro në rastin *Rantsev*, cituar më lartë, § 241, dhe *Aliyeva dhe Aliyev*, cituar më lartë, § 78), përfshirë kur bashkëpunimi ka përfshirë mundësinë e transferimit të procedurave në një shtet tjetër (shih *Huseynova*, cituar më lartë, § 111). Gjykata ka trajtuar në mënyrë specifike mungesën e bashkëpunimit apo të ndihmës për ndonjë hetim të zhvilluar brenda juridiksionit të një shteti tjetër kontraktues në shumë pak raste, përkatësisht në rastin *O'Loughlin, Cummins dhe Rantsev* (shih paragrafët 223 dhe 225 më lartë).

[...]

232. Gjykata më parë ka shprehur qëndrim se gjatë interpretimit të Konventës duhet të kihet parasysh natyra e saj e veçantë si traktat për zbatimin kolektiv të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Shih *Irelanda kundër Mbretërisë së ashkuar*, 18 janar 1978, § 239, seria A nr. 25. duke iu referuar preambulës së saj; *Loizidou kundër Turqisë* (vërejtjet paraprake), cituar më lartë, § 70; dhe *Nada kundër Zvicrës* [GC], nr. 10593/08, § 196, KEDNJ 2012). Kjo natyrë kolektive mundet, në disa rrethana specifike, të nënkuptojë detyrë për shtetin kontraktues që të veprojë bashkërisht dhe të bashkëpunojë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive që kanë marrë përsipër t'i sigurojnë në kuadër të juridiksionit të tyre (shih për shembull, në fushën e trafikimit ndërkufitar të njerëzve sipas nenit 4 të Konventës, *Rantsev*, cituar më lartë, § 289). Në rastet kur hetimi efektiv për ndonjë vrasje të paligjshme e cila ka ndodhur në juridiksionin e një shteti kontraktues kërkon përfshirjen e më shumë se një shteti kontraktues, Gjykata konstaton se natyra e veçantë e Konventës si traktat për zbatim kolektiv në parim përfshinë një obligim në anën e shteteve përkatëse për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me njëri-tjetrin me qëllim të zbardhjes së rrethanave të vrasjes dhe sjelljen e kryerësve para drejtësisë.

233. Gjykata shprehë pikëpamjen se neni 2 mund të kërkojë nga të dy shtetet një obligim të dyanshëm për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, njëkohësisht duke nënkuptuar obligim për të kërkuar ndihmë dhe obligim për të dhënë ndihmë. Natyra dhe fushëveprimi i këtyre obligimeve në mënyrë të pashmangshme do të varen nga rrethanat e çdo rasti të caktuar, për shembull nëse pikët kryesore të provave gjenden në territorin e shtetit kontraktues përkatës apo nëse të dyshuarit kanë ikur atje.'

44. Rreth çështjes së shpejtësisë, Paneli dëshiron të theksojë si në vijim. Sa i përket obligimeve hetimore të tij, sipas mandatit të tij aktual, Misioni është paraparë që të hetojë pretendimet kredibile të shkeljeve të të drejtave të njeriut me kujdes dhe shpejtësi, dhe të sigurojë në të gjitha rastet se reagimet hetimore të Misionit të jenë në proporcion me peshën e çështjes. Në përgjithësi, reagimi duhet të jetë i atillë që të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave në rrezik. Shih, në përgjithësi, *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 56; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 36. Shih edhe *Varnava dhe të tjerët kundër Turqia*, Aplikacioni

nr. 16064/90 dhe të tjerë, aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, par. 191; *Oğur kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21594/93, aktgjykimi i datës 20 maj 1999, par. 88; *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi 4 maj 2001, par. 105-09; *Douglas-Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 56413/00, vendimi i datës 8 janar 2002.

45. Kur obligimi i shtetit apo autoritetit përfshinë detyrën për të bërë hetime, kriteri i shpejtësisë vlen në të gjitha fazat dhe aspektet e hetimit: inicimi, zhvillimi dhe përfundimi i hetimeve. Kriteri i shpejtësisë është relativ për nga natyra: varet prej rrethanave të secilit rast, në veçanti sfidat që dalin nga rasti, vështirësitë për qasjen e dëshmitarëve apo për mbledhjen e informatave. *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57. Por sfidat dhe vështirësitë hetimore nuk e autorizojnë zvarritjen, vonesat apo ngadalësinë e paarsyetuar në kryerjen e detyrave hetimore. Kjo është një shprehje e të drejtës më të gjerë për procedurë pa vonesa të panevojshme, e cila është e garantuar për të gjitha palët në procedura gjyqësore. Shih, prapë, *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57. Andaj, Paneli ka thekuar se –

“E drejta për seanca të drejta dhe publike brenda një afati kohor të arsyeshëm siç kuptohet nën nenin 6 (1) të Konventës është e përcaktuar për t'i mbrojtur “të gjitha palët në procedura gjyqësore ....kundër vonesave procedurale të tepërta ...Përveç kësaj, në rastet penale e drejta është e përcaktuar për të shmangur që një person i akuzuar të mbetet për shumë gjatë në një gjendje të pasigurisë rreth fatit të tij” [...]” (Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, par. 57, citimet janë nga *Stögmüller kundër Austrisë*, Aplikacioni nr. 1602/62, aktgjykimi i datës 10 nëntor 1969, para 5; ritheksuar në *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57).

46. Gjatë vlerësimit, në ndonjë rast të caktuar, të arsyeshmërisë së kohës së kaluar nga autoritetet për hetimin e shkeljeve të pretenduara, janë identifikuar një sërë faktorësh me rëndësi të posaçme, përfshirë: (1) ndërlikueshmëria e rastit, (2) sjellja e aplikuesit, dhe (3) sjellja e administratës kompetente (*Maksutaj kundër EULEX-it*, 2014-18, 12 nëntor 2015, par. 58, dhe referimet te *König v RFGj*, Aplikacioni nr. 6232/73, aktgjykimi i datës 28 qershor 1978, par. 99, *Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës*, Aplikacioni nr. 49017/99, aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2004, par. 45; Shih edhe, *Thomas Rüschke kundër EULEX-it*, 2013-21, 11 janar 2017, par. 59-65; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 58). Shqyrtimi i pasojave të vonesave tek palët e përfshira po ashtu mund të jap prova relevante për arsyeshmërinë apo jo të vonesave përgjatë procesit (*Maksutaj kundër EULEX-it*, 2014-18, 12 nëntor 2015, par. 64-66 dhe referencat e cituara; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 58).
47. Zotimi për, dhe lidhja e pakompromis, me ato standarde është veçanërisht e rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit, siç është EULEX-i Kosovë, i cili ka për qëllim të shërbejë si shembull i zotimit të shoqërisë për përfundimin e mosndëshkueshmërisë dhe ngritjes së ndjenjës së llogaridhënies tek ajo për shkeljet e rënda të të drejtave. Shih *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 55. Çfarëdo standardi që nuk e përfshinë standardin e cekur më lartë do të rrezikonte krijimin e një ndjenje të pranimit në heshtje të mosndëshkueshmërisë dhe mospërfilljes së kërkesës së viktimave për drejtësi dhe llogaridhënie (*S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 55; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 46; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 37; Shih edhe *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, par. 191; *Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*,

Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, par. 63; vendimi i PKDNj për lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 80).

48. Po ashtu duhet të theksohet për qëllimet aktuale se të drejtat që janë temë e ankesës aktuale janë në mesin e të drejtave më të rëndësishme të të drejtave themelore. Ato prekin interesat thelbësore të viktimave të supozuara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjeve me forcë përbënë shkelje flagrante të këtyre të drejtave. *Ndër të tjera* kjo reflektohet në faktin se praktika e “zhdukjeve me forcë” tani konsiderohet dhe karakterizohet si krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (Ligji nr. 05/L-053) (neni 13(1)(i)). Shih edhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 59.
49. Implikimet e ndryshimeve të mandatit të Misionit pas mbylljes në qershor 2018 dhe implikimet e tij për qëllime të këtij rasti janë të trajtuara shkurtimisht në vazhdim.

### Rastet e “zhdukjeve me forcë” në kontekstin e mandatit të Misionit

50. ShM nuk e konteston se Misioni ka qenë kompetent për hetimin e këtij rasti dhe ka mundur ta bënte atë gjatë ushtrimit të kompetencave të tij juridiksionale.
51. Paneli tanimë ka përcaktuar se ky lloj i rasteve bie në kuadër të mandatit ekzekutiv dhe kompetencave hetimore/prokuroriale të Misionit. Shih, p.sh., *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015; *Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019.
52. Kur aktet, si zhdukjet me forcë, kryhen në kontekstin e përgjithshëm të konfliktit të armatosur, siç ka ndodhur në këtë rast, veprimi në fjalë ka mundësi të cilësohet si krim lufte, krim kundër njerëzimit apo krim mbi baza etnike, për të cilat Misioni ka patur kompetencë juridiksionale specifike dhe direkte sipas mandatit në fuqi atë kohë. Shih, në përgjithësi, neni 3 (d) i veprimit të përbashkët të Këshillit. Shih edhe *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 44-46. Në rastin *D.W. e tutje*, Paneli theksoi si në vijim në lidhje me këtë çështje:

‘ka ekzistuar mundësia e vërtetë që ato krime dhe shkeljet pasuese të të drejtave janë bazuar në përkatësi etnike apo fetare, duke u shtrirë kështu në territorin juridiksional për të cilin Misioni ka pasur kompetenca. Në një mjedis pas konfliktit ku raportet etnike dhe fetare ende mund të jenë të tensionuara dhe të brishta, këto raste qartazi janë prioritete hetimore..’

Shih *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., dhe I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 to 2014-17, 19 tetor 2016, par. 83 e tutje, në veçanti par. 85.

53. Hetimi i këtyre llojeve të rasteve jo vetëm se ka qenë pjesë e mandatit të Misionit, por ka qenë edhe element thelbësor dhe esencial i tij. Në lëndën *L.O. kundër EULEX-it*, Paneli theksoi se –

'mund të ketë pak kontestim se hetimi i fatit të të zhdukurve – pavarësisht përkatësisë fetare apo etnike – duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in si Misioni i sundimit të ligjit, për çka ai duhet të pajiset me burime adekuate'

*L.O. kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 47. Shih edhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019.

54. Konsiderimet e sipërme do të shërbejnë për vlerësimin e përpjekjeve të bëra nga Misioni në lidhje me rastin aktual dhe nëse këto përpjekje mund të quhen si konsistente me mandatin e përgjithshëm të Misionit dhe obligimet e tij për të drejtat e njeriut.

#### **Rrethanat në të cilat Misioni është dashur t'i përmbushë përgjegjësitë e veta për të drejtat e njeriut**

55. Për arsyet e dhëna më lartë, Misioni nuk duhet të vlerësohet kundrejt standardeve të përsosmërisë. Atë kohë Misioni është ballafaquar me një mjedis sfidues të pas konfliktit. Burimet e tij ishin të kufizuara dhe, në disa aspekte, ato ishin joadekuate për detyrën dhe pritshmëritë. Kjo ka bërë që Misioni të bëjë zgjedhje dhe të prioritetizojë përpjekje të caktuara kundrejt të tjerave.
56. Më tej, mënyra në të cilën UNMIK-u i ka ndërmarrë përpjekjet e veta hetimore dhe mënyra në të cilën ai i ka transferuar dosjet e veta te EULEX-i ka bërë që puna e Misionit të ndërlikohet në masë të madhe. Si reagim, Misioni ka investuar kohë, burime dhe energji për shqyrtimin e regjistrave dhe për përpjekjet për t'i qartësuar ato. Për këto përpjekje, Misioni duhet të përgëzohet.
57. Në vlerësimin e kësaj ankese, Paneli ka marrë parasysh vështirësitë në hetimin e krimeve të ndërlidhura me luftën në një shoqëri pas konflikti siç është Kosova (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 44 dhe referencat e cituara aty; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 51; Shih edhe *Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, par. 70; dhe vendimi i PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 44 dhe 62 e tutje). Ato vështirësi, megjithatë, nuk duhet të shërbejnë për të kamufluar apo arsytuar dështimet e hetimeve të cilat nuk janë të lidhura në asnjë mënyrë kuptimplotë me vështirësitë e cekura. Andaj, Paneli do të vlerësojë në çdo rast nëse ndonjë hap i caktuar hetimor që normalisht ka qenë i hapur për EULEX-it do të ishte bërë jopraktik për arsye që ndërlidhen me rrethanat e paskonfliktit pavarësisht atyre që kanë zhvilluar hetimin (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 44; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 51).
58. Një fakt që është në veçanti relevant për vlerësimin e reagimit të Misionit është ai se mundësia e tij për përmbushjen e obligimeve të tij – hetimore – është ndikuar si nga rrethanat e përgjithshme në të cilat krimet janë kryer ashtu edhe nga veprimi i UNMIK-ut pas kryerjes së atyre krimeve. Krimet e kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur janë pothuajse gjithnjë sfidë për t'u hetuar. Sfidat shpesh mbetet menjëherë pas konfliktit për shkak se provat mund të shkatërrohen dhe gatishmëria dhe mundësia e dëshmitarëve për dhënien e informatave mund të ulet në masë të konsiderueshme në një kontekst të tillë. Paneli i ka marrë parasysh mirë këto sfida me rastin e vlerësimit që ia ka bërë reagimit të Misionit. Shih prapë *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 52-53.

59. Paneli po ashtu ka marrë parasysh faktin se EULEX-i Kosovë është dashur që të ballafaqohet me trashëgiminë hetimore të UNMIK-ut dhe të trajtojë atë. Nga të dhënat për këtë rast dhe për raste të tjera që kanë dalë para Panelit është e dukshme se UNMIK-u në shumë aspekte ka dështuar t'i përmbushë obligimet e veta për të drejtat e njeriut sa i përket viktimave të "zhdukjeve me forcë". Kjo është theksuar nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, i cili përcaktoi se UNMIK-u i kishte shkelur të drejtat e viktimave të akteve të tilla në disa raste. Mbatja e duhur, e kujdesshme dhe e organizuar e regjistrave rrëth kryerjes së shkeljeve të tilla të rënda të të drejtave është element i rëndësishëm i mbrojtës efektive të atyre të drejtave. Sa i përket natyrës dhe peshës së akteve nën konsiderim, praktika e UNMIK-ut për mbajtjen e regjistrave ka qenë jo e duhur. Paneli nuk do t'ia atribuon Misionit mangësitë dhe të metat të cilat duhet t'i drejtohen UNMIK-ut. Paneli ka marrë në konsiderim ato rrethana me rastin e vlerësimit të veprimeve të Misionit dhe të sfidave me të cilat është ballafaquar. *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 53.

### Gjetjet rreth dështimeve të pretenduara të Misionit

60. Siç është theksuar më lartë, nuk vihet në pikëpyetje se Misioni ka punuar në rrethana të vështira për shumicën e kohës sa i përket këtij rasti.
61. Nga regjistri i këtij rasti, po ashtu është e qartë se Misioni ka ndërmarrë një sërë hapash relevant për ankesën në fjalë. Në veçanti, ai ka ndërmarrë hapa aktivë për shqyrtimin dhe organizimin e regjistrave që i ka marrë nga UNMIK-u. Dhe Instituti Forenzik ka qenë drejtpërdrejt i përfshirë në përpjekjet për gjetjen e familjarit të ankuesit apo të mbetjeve mortore të tij.
62. Megjithatë, përpjekjet nuk kanë bërë mjaftë për të mbrojtur dhe garantuar efektshmërinë e të drejtave themelore të ankuesit dhe të babait të tij. Paneli ka identifikuar një sërë mangësish tek veprimet e Misionit të cilat kanë rezultuar apo kanë kontribuar në shkelje të të drejtave të ankuesit:
- i. Hetimi jo i plotë dhe jo i kujdesshëm i rastit, përfshirë, ndër të tjera, mungesa e bashkërendimit të duhur mes organeve të Misionit; dhe
  - ii. Përfshirja dhe informimi i pamjaftueshëm i familjarëve të të zhdukurit.

### Hetimi i zhdukjes së familjarit të ankuesit

63. Si çështje paraprake, Paneli dëshiron të theksojë dallimin mes çështjes së kompetencës për të hetuar dhe çështjes së obligimit për të hetuar. *Kompetenca* e Misionit për hetimin e krimeve që përfshijnë shkeljen e të drejtave të caktuara të njeriut – dhe fushëveprimi – është përcaktuar nga një sërë ligjesh të vendit, në veçanti, nga Ligji për Juridiksionin në përsëritjet e tij të shumta. Sa i përket *obligimit* të Misionit për hetimin e tyre, ai nuk përcaktohet me dispozitat për kompetencën juridiksionale të prokurorëve të EULEX-it për këto raste, por me nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (dhe dispozitat e ngjashme për të drejtat e njeriut), që e mandatojnë Misionin për garantimin e efektivitetit të këtyre të drejtave në kontekstin e funksionit të tij ekzekutiv. Shih p.sh. *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, par. 84 et seq. Shih edhe, për një ilustrim të aplikimit të atij nocioni të përgjithshëm: lënda *Gudiel Alvarez e tutje ("Diario Militar") kundër Guatemalës* (Aktgjykimi i datës 20.11.2012; Meritat, Reparacionet dhe shpenzimet), në veçanti, par. 192, 231-232. Shih edhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 83.

64. Gjatë përmbushjes së mandatit të tij ekzekutiv, nga Misioni kërkohet që të interpretojë kompetencën e tij – natyrën dhe fushëveprimin e tij – në pajtueshmëri dhe në konsistencë me obligimin e tij për të drejtat e njeriut. Paneli së pari do të shqyrtojë çështjen e kompetencës së Misionit për hetimin e rasteve siç është rasti nën shqyrtim.
65. Deri më 15 prill 2014, EULEX-i Kosovë ka pasur kompetencë të papenguar për hetimin e rasteve të këtij lloji (Shih Ligji nr. 03/L-053 për Juridiksionin, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, neni 3, dhe Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës). Paneli ka theksuar në vendime të mëparshme se raste të këtij lloji mund të hetohet – dhe, në të vërtetë, në disa raste, janë – hetuar si krime të luftës apo krime të motivuara etnikisht. Andaj, nga fillimi i mandatit të tij deri në prill 2014 (pra, përfshirë periudhën e pas-lirimit nga akuza, 2007-2014), Misioni në të vërtetë ka qenë kompetent për hetimin apo vazhdimin e hetimit të këtij rasti. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 85.
66. Më 15 prill 2014, fushëveprimi i kompetencave të prokurorëve të EULEX-it është ngushtuar dhe kufizuar për “rastet në proces e sipër”, pra për rastet që janë hapur nga EULEX-i para asaj kohe (Shih Ligjin nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve për mandatin e EULEX-it, neni 3.3). Paneli thekson si në vazhdim në lidhje me periudhën mes prill 2014 dhe qershor 2018: Së pari, vendimi për hapjen apo mos hapjen e një rasti të ri i përkiste prokurorëve të EULEX-it (në bashkëpunim me autoritetet kompetente të vendit) aty ku ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme. Andaj, vendimi për të mos hapur apo për të mos rihapur ndonjë hetim të këtij rasti ishte vendim i marrë – në mënyrë shprehimore apo të nënkuptuar – nga prokurorët e EULEX-it. Shih edhe *X. dhe 115 të tjerët kundër EULEX-it*, lënda nr. 2011-20, Vendimi dhe gjetjet, 22 prill 2015, par. 60-67; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 86.
67. Së dyti, ai obligim për hetim duhet të interpretohet nga aspekti i obligimeve të Misionit për të drejtat e njeriut sipas planit operacional. Duke pasur parasysh se shkelja e të drejtave të viktimave dhe të ankuesit ka qenë e vazhdueshme, i ka takuar Misionit që të sigurojë se ato të drejta të mbrohen në mënyrë efektive dhe se shkelja e tyre të zgjidhet siç duhet.
68. Më tej, Ligji për Juridiksionin në fuqi gjatë asaj periudhe (prill 2014 - qershor 2018) ka përmbajtur një klauzolë në bazë të së cilës Misioni mund të ushtronte kompetencë mbi raste (pra, për ato që nuk kanë qenë “në proces” në maj) kur kanë ekzistuar “rrethana të jashtëzakonshme”. Paneli tani më ka pasur rastin ta interpretojë këtë nocion. Ai e ka interpretuar atë në një mënyrë që i jep efekt përgjegjësisë së përgjithshme të Misionit për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut në kontekstin e mandatit të tij ekzekutiv. Andaj, në lëndën *Sadiku-Syla*, Panel theksoi si në vijim:

“ShM-ja parashtron se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi më 17 maj 2014 “ka zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e prokurorëve dhe gjykatësve të EULEX-it që të ushtrjnë funksione ekzekutive në raste të reja” (Përgjigja, faqja 6, duke iu referuar Ligjit Omnibus që ka ndryshuar Ligjin për juridiksionin). Paneli vëren, megjithatë, se neni 7(A) përcakton “Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme”: “Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t’i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët të kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX-it Kosovë.” ShM nuk ka shpjeguar se përse kjo dispozitë nuk do të ishte bazë ligjore adekuate mbi të cilën duhet të veprojnë prokurorët e EULEX-it, në veçanti në një rast si rasti në fjalë, ku autoritetet vendore nuk duket se janë duke kryer hetime.



Paneli do t'i ftonte palët të adresojnë këtë çështje nëse ata dëshirojnë të bëjnë parashtrësë shtesë në lidhje me meritat e këtij rasti”.

Shih *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 29 shtator 2015, par. 62. Shih edhe, *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, par. 90; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 23 e tutje; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 88.

69. Ndryshe, nga regjistri i rasteve që paraqiten para Panelit – përfshirë rastin aktual – duket se EULEX-i në shumë raste nuk i ka trajtuar këto lloje të rasteve si prioritete hetimore apo, së paku, të përkushtojë kohë dhe burime të nevojshme për zhvillimin e hetimeve efektive për ato raste. Shih, p.sh., *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, par. 34- 39; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 to 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 72-76; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 43- 47, dhe 59-65; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 47; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 58, 60, 62-65, 81-82; dhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 89.
70. Në këtë rast të caktuar, Misioni e ka pranuar mos hetimin e këtij rasti. Megjithatë ai ka theksuar se Instituti Forenzik ka qenë dhe vazhdon të jetë i përfshirë në këtë çështje për një kohë goxha të gjatë (shih, *supra*, par. 26 dhe 27). Përfshirja e Institutit Forenzik në këtë çështje me të vërtetë është për t'u pranuar dhe ka shkuar deri diku drejtë përmbushjes së obligimeve të Misionit. Megjithatë, përgjegjësia e Institutit Forenzik ka qenë vetëm forenzike në kuptimin e kërkimit të gjetjes dhe identifikimit të mbetjeve mortore të familjarit të ankuarit. Kjo nuk cilësohet si kriteri që përcakton se autoritetet duhet të hetojnë dhe t'i zbardhin rrethanat e zhdukjes së ndonjë individi dhe t'i sjellin përgjegjësit para drejtësisë, apo nuk e përmbushë atë kriter.
71. Në atë kuptim, ndonëse Misioni ka ndërmarrë disa hapa drejt përmbushjes së këtij obligimi në këtë rast, këto përpjekje nuk kanë qenë të mjaftueshme për t'i plotësuar standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara më lartë, të cilat kanë qenë të detyrueshme për Misionin atë kohë.
72. Paneli thekson më tej se mungesa e prioriteteve të qarta mund të ketë ndikuar negativisht në mundësinë e Misionit për t'u përqendruar në rastet e këtij lloji. Mangësi tjetër është edhe bazueshmëria e Misionit në klasifikimin e rasteve nga UNMIK-u si të hapura apo të mbyllura dhe si raste të krimeve të luftës/personave të zhdukur. Klasifikimi i rasteve nga UNMIK-u duket se është bërë pa përpjekje për kryerje apo pa kryerje të hetimeve të plota dhe të duhura të rasteve, dhe në shumë raste pa kontaktimin apo informimin e familjarëve të të zhdukurve. Misioni është dashur të bëjë vlerësim dhe hetim nga vet Misioni dhe të mos i merr vendimet e veta për fillimin ose jo të hetimeve në bazë të informatave që mund të kenë qenë nëpër dosjet e UNMIK-ut.
73. Më tej, Paneli thekson se janë bërë pak apo edhe aspak përpjekje për rastet e këtij lloji dhe, në veçanti, për këtë rast, për të komunikuar me institucione dhe organizata të tjera (si KNKQ, ICTY/TNPJ; OJQ; autoritete të shtetit) të cilat kanë mundur të kenë informata rreth këtyre rasteve apo ekspertizë relevante për t'i ndihmuar përpjekjeve hetimore të Misionit.
74. Andaj, para vendimit për të mos e hetuar ndonjë rast, nga Misioni është dashur të pritej që t'i shtirte të gjitha rrugët e arsyeshme të informimit, përfshirë përmes kontaktimit të

familjarëve të të zhdukurit për të siguruar nëse ata kanë ndonjë informatë relevante për rastin.

75. Paneli e refuzon pohimin e pambështetur dhe të paverifikuar të Misionit se hetimi për këtë rast nuk do të kishte mundësi që të shpinte në zbulimin e provave të reja apo në gjetjen e të vërtetës. Vetëm një përpjekje e vërtetë dhe efektive për zbardhjen e kësaj çështjeje do të kishte dhënë një verifikim të vlefshëm për atë pohim.
76. Në fund, Paneli thekson se mundësia e Misionit për hetimin e rasteve të këtij lloji është zvogëluar më tej me vendimin e shteteve të BE-së në vitin 2014 për *heqjen* e kapacitetit të inteligjencës dhe të hulumtimeve (Shih, *supra*, par.25). Kur një mision i sundimit të ligjit themelohet me përgjegjësi për hetimin e rasteve penale të ndërlikuara, siç ka qenë ky rast, është përgjegjësi e shteteve dhe e organeve kompetente të BE-së për të siguruar që Misioni t'i ketë të gjitha burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të veta në mënyrë efektive dhe në një mënyrë konsistente me obligimet për të drejtat e njeriut.

#### *Dhënia e informatave mes organeve të Misionit*

77. Një aspekt i caktuar i mosveprimit të Misionit sipas standardeve të pritura të kujdesit të duhur gjatë kryerjes së obligimeve të veta hetimore i përket mospërcaktimit të informatave në posedim të disa organeve të vihen në dispozicion të entiteteve të tjera relevante brenda Misionit.
78. Misioni ka shpjeguar praktikën e zakonshme të organeve të Misionit për përpjekjet për bashkërendimin e përpjekjeve për dhënie të informatave për raste të tilla. Megjithatë, Misioni nuk ka mundur të shpjegojë se përse kjo nuk ka ndodhur për këtë rast dhe përse, në veçanti, dosjet në posedim të Institutit Forenzik nuk kanë kaluar në posedim të autoriteteve hetimore dhe prokuroriale të Misionit.
79. Kjo mungesë e bashkërendimit të duhur të gjërave brenda Misionit dhe mungesa e të siguruarit të krijimit të mekanizmave dhe procedurave për të siguruar centralizimin e informatave të ndjeshme për këtë lloj të rasteve ka kontribuar në krijimin e një situatë ku prokurorët e PSRK-së morën vendim që të mos e hetonin këtë rast pa e ditur plotësisht se çfarë informata i ka poseduar Misionit në kohën përkatëse. Është dashur të jenë krijuar mbrojtje të duhura për të shmangur një situatë të tillë. Shih edhe *Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, par. 60-61; dhe *Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 39-40.

#### *Informimi i familjarëve të të zhdukurve*

80. Për shkak të ndikimit të akteve të zhdukjeve me forcë të familjarët e të zhdukurve, është thelbësisht e rëndësishme që ata duhet të jenë të përfshirë në hetimin e rasteve të tilla në masën më të madhe që është e mundur. *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66.
81. Autoriteteve hetimore iu kërkohet që, si çështje e së drejtës për të drejtat e njeriut, t'i informojnë viktimat e këtyre shkeljeve rreth procesit të hetimeve të tyre. Në fakt, kjo kërkon që ato t'i balancojnë të drejtat dhe interesat e viktimave për të qenë të informuar rreth progresit të hetimeve me shkaqet e nevojshme të konfidencialitetit që hetimet në mënyrë legjitime mund të kërkojnë. Duke iu nënshtruar konsiderimeve të konfidencialitetit dhe të sigurisë, viktimat kanë të drejtë që të jenë mjaftueshëm të përfshira në procesin e hetimeve dhe të jenë të informuara rreth tij. Ndonëse përmbajtja

e saktë së asaj që duhet t'i jepet atyre është vështirë të përcaktohet në një përmbledhje, informatat e që iu jepen atyre që më së drejtpërdrejt janë të prekur nga hetimet duhet të jenë të atilla që ua bëjnë të mundur të jenë të përmbushur se çështja është duke u shqyrtuar siç duhet dhe se janë duke u bërë të gjitha përpjekjet relevante dhe të arsyeshme për gjetjen e fatit të familjarëve të tyre dhe për identifikimin e përgjegjësve të atyre akteve. Shih, në përgjithësi, *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-73; PShDN, Shënim i praktikës gjyqësore për detyrën për hetimin e pretendimeve të shkeljeve të të drejtave, fq. 28-30; Shih edhe *Anmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 6 prill 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër Rosisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 24 shkurt 2005 par. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167.

82. Ky obligim për t'i informuar viktimat rreth përpjekjeve hetimore është në veçanti i rëndësishëm në rastet që përfshijnë akte të zhdukjes me forcë, meqë familjarët e gjallë mund të mos kenë burime të tjera të informimit rreth fatit të të afërmeve të tyre dhe ata do të vazhdojnë të jetojnë me shpresën se fati i të afërmeve të tyre një ditë do të zbardhet. Si rezultat, familjarët e viktimave të zhdukura vuajnë emocionalisht nga mungesa e informatave rreth fatit të më të dashurve të tyre. Shih *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 78. Kjo kërkesë është element i nevojshëm i mbrojtjes së të drejtave të viktimave gjatë hetimit të rasteve të tilla. Shih, p.sh., *H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 77; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 86; Shih edhe *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së së datës 6 prill 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër Rosisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 24 shkurt 2005 par. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 7 korrik 2011, par. 167. Dhe autoritetet kompetente nuk do të lejohen lehtë që të mos e përfillim apo ta injorojnë atë. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 67.
83. Në këtë kontekst është relevante edhe e drejta e viktimës për të vërtetën, e cila buron nga kategoritë e tjera të pranuar të të drejtave të njeriut. Duke e theksuar të drejtën e viktimave për të vërtetën në këtë kontekst, *Komenti i përgjithshëm* i grupit punues për zhdukjet me forcë thekson si në vijim në lidhje me këtë çështje:

“Neni 13 i Deklaratës njih obligimin e shtetit për të hetuar rastet e zhdukjeve me forcë. Paragrafi 4 i nenit 13 specifikon se "gjetjet nga një hetim i tillë do të vihen në dispozicion sipas kërkesës për të gjithë personat e interesuar, përveç nëse veprimi i tillë do të rrezikonte hetimin penal që është në proces." Duke pasur parasysh zhvillimet që kanë ndodhur që nga viti 1992, Grupi punues gjykon se kufizimi në pjesën e fundit të këtij paragrafi duhet të interpretohet ngushtë. Në të vërtetë, të afërmit e viktimave duhet të lidher ngushtë me hetimin për rastin e zhdukjes me forcë. Refuzimi për të dhënë informacion është kufizim i së drejtës për të vërtetën. Një kufizim i tillë duhet të jetë rreptësishtë proporcional me qëllimin e vetëm të ligjshëm: për shmangien e rrezikimit të hetimit penal në proces. Refuzimi për të dhënë ndonjë informacion, ose për të mos komunikuar fare me të afërmit, me fjalë refuzimi absolut, është shkelje e së drejtës për të vërtetën. Dhënia e informatave të përgjithshme për çështjet procedurale, siç është fakti se çështja i është dhënë një gjykatësi për shqyrtim, është e pamjaftueshme dhe duhet të

konsiderohet shkelje e së drejtës për të vërtetën. Shteti ka obligim që ta informojë çdo person të interesuar rreth hapave konkretë të ndërmarrë për zbardhjen e fatin të personit dhe vendndodhjen e tij. Këto informata duhet të përfshijnë hapat e ndërmarrë në bazë të provave të ofruara nga të afërmit ose dëshmitarët e tjerë. Ndërsa nevojat e hetimit penal mund të arsyetojnë kufizimin e transmetimit të informatave të caktuara, legjisllacioni i vendit duhet të përcaktojë mundësinë për ta shqyrtuar një refuzim të tillë për t'i dhënë informata të gjithë personave të interesuar. Ky shqyrtim duhet të jetë në dispozicion në kohën e refuzimit fillestar për dhënie të informatave, dhe pastaj në mënyrë të rregullt për të siguruar që arsyeja e nevojës që është ngritur nga autoriteti publik për refuzimin e komunikimit, të vazhdojë të jetë e pranishme.”

Shih *Komentin e përgjithshëm për të drejtën për të vërtetën rreth zhdukjeve me forcë*, raporti i grupit punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme (2010), dokumenti A/HRC/16/48, par 3; *Zufe Miladinović kunoër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; dhe, po ashtu, I. Lënda *Rio Negro Massacres/Masakrat e Lumit të Zi kundër Guatemalës* (GjNADNj) (Aktgjykimi i datës 4.09.2012, kundërshtimi preliminar, meritat, riparimi dhe kostot), par. 265. Shih edhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 78.

84. Sa i përket rastit aktual, në regjistrat e Misionit nuk ka indikacione për përmbushjen e obligimit të tij për informimin e ankuesit rreth ekzistencës, procesit dhe rrjedhës së hetimeve.
85. Misioni nuk ka dhënë shpjegime për mos informimin e ankuesit (apo të ndonjë familjari tjetër të viktimës parësore) rreth këtij rasti. Si përgjigje ndaj pyetjes së Panelit për atë pikë, Misioni tha si në vijim:

‘Në përgjithësi, Misioni është dashur të bëjë më shumë përpjekje komunikuese për informimin e viktimave dhe të publikut të gjerë në lidhje me strategjitë dhe qasjet e tij, me qëllim të menaxhimit të pritshmërive në mënyrë më adekuate dhe më transparente. Megjithatë, në rastin aktual, dhe duke i pasur parasysh pengesat themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit janë shkelur dhe duke e pasur parasysh atë që u tha më lartë thekson se ai ka bërë atë që ka qenë e mundshme në mënyrë të arsyeshme për të vërtetuar fatin e Dušan Adančić.’

86. Obligimi i Misionit ndaj kësaj kategorie të viktimave nuk i përket “strategjive” ose “qasjeve”. As nuk bëhet fjalë për komunikim. Kjo i përket të drejtës së viktimave të një shkeljeje të tillë të të drejtave të tyre për t’u informuar posaçërisht për atë që autoritetet janë duke bërë për të zbardhur çështjen dhe për t’i sjellë përgjegjësit para drejtësisë. Duke mos kontaktuar me ankuesin dhe madje as duke mos bërë përpjekje për të kontaktuar, Misioni në fakt i ka shkelur të drejtat e tij.
87. Mos kontaktimi dhe mos informimi i ankuesit nga ana e Misionit sa i përket vendimit të tij për të mos e hetuar këtë rast ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit deri në atë masë sa që ka rritur gjendjen e pasigurisë në të cilën ai ka qenë gjatë periudhës përkatëse.

#### **Mandati i ri, i reduktuar, i Misionit që nga qershori 2018**

88. Mandati i ri i Misionit, i cili ka filluar në qershor 2018, ka reduktuar në masë të konsiderueshme mundësinë e Misionit për hetimin e rasteve penale, përfshirë rastin aktual. Roli i tij i ri i monitorimit nuk ia mundëson që të kërkojë fillimin e ndonjë hetimi, e

as nuk i jep autoritet për të vendosur rreth procesit të hetimeve. *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 98.

89. Paneli konsideron se ndryshimi i natyrës së mandatit të Misionit nuk e liron Misionin nga obligimi i tij për rregullimin sa është e mundur të ndikimeve të shkeljeve për të cilat përcaktohet se është përgjegjës. Shih edhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 99; dhe Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/856 i datës 8 qershor 2018.
90. Mbi këtë bazë, Paneli do të rekomandojë që Misioni më tej të ndërmarrë hapa aktivë për të kërkuar nga autoritetet kompetente të vendit se çfarë masash, nëse ekziston ndonjë, janë duke u marrë për të hetuar këtë rast dhe për të raportuar tek autoritetet kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet e vendit nuk janë duke i përmbushur obligimet e tyre në atë aspekt. Për shkak të dështimit për mbrojtjen e të drejtave të ankuesit, Misioni tani duhet të ndërmarrë hapa për të kërkuar rregullimin e këtyre shkeljeve.

### **Pasojat mbi të drejtat e ankuesit dhe të drejtat e babait të tij**

91. Neni 2 i Konventës mbron një prej të drejtave më themelore të njeriut, përkatësisht, të drejtën për jetë. Ajo e drejtë mbrohet me një varg instrumentesh për të drejtat e njeriut dhe ajo përbënë element thelbësor dhe bazik të mbrojtjes minimale të të drejtave të njeriut detyruar çdo individ. Ajo njihet vetëm pak përjashtime, dhe të kufizuara. Shih, në përgjithësi, *Komenti i përgjithshëm nr. 36 (2018) për nenin 6 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, për të drejtën për jetë*, CCPR/C/GC/36, 30 tetor 2018 ([https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1\\_Global/CCPR\\_C\\_GC\\_36\\_8785\\_E.pdf](https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1_Global/CCPR_C_GC_36_8785_E.pdf)) (më tej në tekst, "*Komenti i përgjithshëm 36*"); *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 106.
92. Më e rëndësishmja për qëllimet e tanishme, kjo e drejtë paraqet obligim procedural në anën e shtetit ose autoritetit kompetent për të hetuar aty ku ata e dinë ose duhet të kishin ditur për privimet potencialisht të paligjshme të jetës, për të hetuar dhe, kur është e përshtatshme, për të ndjekur penalisht raste të tilla, përfshirë pretendimet për përdorim të tepërt të forcës me pasoja vdekjeprurëse. Shih, në përgjithësi, *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 107; Shih edhe *Nydia Erika Bautista de Arellana kundër Kolumbisë*, komunikimi nr. 563/1993, Qëndrimet e komitetit për të drejtat e njeriut, 27 tetor 1995 par. 8.6; *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 27 shtator 1995, seria A nr. 324, par. 161; *Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 tetor 1998, Raportet për gjykimet dhe vendimet 1998-VIII, par. 102; *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aplikacioni nr. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 korrik 2005, par. 110; *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi i GjEDNj-së 4 maj 2001, par. 105; *Komenti i përgjithshëm 36*, par. 27; Këshilli për të drejtat e njeriut, vërejtjet përmbyllëse: Kyrgyzstan (2014), par. 13.
93. Hetimet dhe ndjekjet penale të privimeve potencialisht të paligjshme nga jeta duhet të ndërmerren në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare relevante, përfshirë *Protokollin e Minesotës për hetimin e vdekjeve potencialisht të paligjshme* (2016), dhe duhet të kenë për qëllim të sigurojnë sjelljen e përgjegjësve para drejtësisë, promovimin

e llogaridhënies dhe parandalimin e mosndëshkueshmërisë, mënjanimin e shmangies nga drejtësia dhe nxjerrjen e mësimëve të nevojshme për revidimin e praktikave dhe politikave me qëllim të shmangies së përsëritjes së shkeljeve. Shih, në përgjithësi, *Komenti i përgjithshëm 36*, par. 27 dhe referencat e cituara; dhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 108.

94. Për këtë rast relevant është edhe neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të cilin përcaktohet se askush nuk i nënshtrohet torturës apo trajtimin apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues. Një ndalesë dhe garanci e ngjashme përcaktohet edhe në shumë instrumente të tjera për të drejtat e njeriut, përfshirë në nenin 7 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike dhe nenin 2 të Konventës kundër torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor apo degradues. Kjo prapë është e drejtë themelore e një rëndësie enorme e cila duhet të mbrohet në çdo kohë dhe rrethanë.
95. Në jurisprudencën e Panelit dhe në praktikën e organeve të tjera për të drejtat e njeriut është pranuar se trauma emocionale që shkaktohet tek familjarët e ndonjë të zhdukuri nga mungesa e informatave rreth fatit të të afërmit të tyre mund të arrijë pragun e peshës që kërkohet për këtë garanci. Shih, p.sh., *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 to 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019. Shih edhe Deklaratën për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë, paragrafi preambular i 5-të (ku theksohet se zhdukjet me forcë shkaktojnë “ankth dhe pikëllim”) dhe neni 1(2) ku përcaktohet se “çdo akt i zhdukjes me forcë (...) përbënë shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare që garanton, (...) të drejtën për të mos iu nënshtuar torturës apo trajtimit apo ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor apo degradues”); dhe *Komentin e përgjithshëm për të drejtën për të vërtetën në lidhje me zhdukjet me forcë*, Raporti i grupit punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme, 2010. Dokumenti A/HRC/16/48, par. 4.
96. Në pikëpamjen e Panelit, dështimi i Misionit për a) bashkërendimin e duhur në mes të organeve të veta për të siguruar se të gjitha informatat relevante të jenë dhënë para marrjes së ndonjë vendimi për hetimin e këtij rasti, b) informimin e të afërmeve rreth veprimeve të Misionit në lidhje me këtë rast dhe c) përdorimin e të gjitha mjeteve hetimore në dispozicion për t’u përpjekur për ta zcjidhur këtë rast, të gjitha kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit nga neni 2 i Konventës për hetimin e këtij rasti në mënyrë të plotë dhe me kujdes nga ana e Misionit.
97. Këto dështime dhe lëshime fajësuese po ashtu kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit nga neni 3 i Konventës dhe kanë kontribuar në traumën emocionale dhe psikologjike të shkaktuar nga mosdija se çka i ka ndodhur babait të tij. Ajo traumë është e rëndë, e gjatë dhe e vazhdueshme. Nuk është, natyrisht, ekskluzivisht pasojë e veprimit të Misionit, por Paneli nuk është kompetent për të bërë përcaktime rreth përgjegjësisë së UNMIK-ut në atë drejtim. Sidoqoftë, dështimi i UNMIK-ut, sado i rëndë, nuk do ta arsyetonte dështimin e Misionit. Andaj, gjetjet e bëra këtu kufizohen për ato veprime dhe dështime të Misionit që i kanë kontribuar shkeljes së të drejtave të ankuesit dhe të babait të tij, pas konsiderimit të sfidave të cekura më lartë me të cilat Misioni është ballafaquar atë kohë.
98. Paneli rithekson, megjithatë, se koha dhe burimet që Misioni i ka investuar për përpjekjet për gjetjen e familjarit apo mbetjeve mortore të familjarit të ankuesit nuk kanë qenë të pakta.

99. Në aspektin e gjetjeve të paraqitura më lartë për nene: 2 dhe 3 të Konventës, Paneli nuk është i mendimit se ka nevojë që të konstatojë gjetje edhe për nenet 8 dhe 13 të Konventës. Paneli thekson, megjithatë, se ndonëse interesi (interesat) e mbrojtura nga çdo dispozitë kanë ngjashmëri të pjesërishme, ato nuk janë identike. Paneli thekson, më tej, se veprimi që i atribuohet Misionit duket *prima facie* të ketë prekur negativisht të drejtat e ankuesit për jetë familjare dhe të drejtën e t j për rregullim efektiv. Paneli nuk do të bëjë gjetje definitive për këto të drejta meqë gjetjet e tij për nenet 2 dhe 3 përmbledhin ato që ai i konsideron tipare thelbësore të shkeljeve që i atribuohen Misionit.
100. Në bazë të asaj që u tha më lartë, Paneli ka përcaktuar se Misioni i ka shkelur të drejtat e ankuesit dhe të babait të tij nga neni 2 (pjesa procedurale) dhe neni 3 i Konventës.

### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJEZËRI**

**GJEN** se Misioni i ka shkelur të drejtat e ankuesit të garantuara me nenin 2 (pjesa procedurale) dhe me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

**NË BAZË TË KËSAJ, PANELI NUK E GJEN TË NEVOJSHME** të bëjë përcaktime rreth shkeljeve të mundshme të neneve 8 dhe 13 të Konventës nga ana e Misionit;

**THEKSON** se, në bazë të të dhënave që Paneli i posedon, shkelja e të drejtës së ankuesit mund të jetë në vazhdim e sipër, andaj,

**REKOMANDON** si në vijim:

- i. Duke marrë parasysh peshën e shkeljeve nën shqyrtim, Paneli i bën ftesë Shefit të Misionit që me kujdes ta shqyrtojë mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranon kryerjen e shkeljes së të drejtave të ankuesit nga ana e Misionit;
- ii. Paneli i bën ftesë Misionit që të sigurojë se dosja e këtij rasti dhe ky vendim t'i dërgohen autoriteteve kompetente të vendit;
- iii. Paneli rekomandon që ky rast duhet të jetë subjekt i monitorimit nga Misioni;
- iv. Paneli rekomandon se, siç ka bërë për rastin 2017-02, Misioni duhet të shqyrtojë dhënien e rekomandimeve tek autoritetet në lidhje me proceset hetimore të mundshme në të ardhmen të cilat do të mund të ndihmonin për zgjidhjen e këtij rasti; në atë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni duhet të theksojë rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe për t'u informuar rreth procesit të përgjithshëm të hetimeve;
- v. Paneli rekomandon se Misioni duket të raportojë tek autoritetet kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet e vendit nuk janë duke i përmbushur obligimet e veta në atë aspekt;
- vi. Misioni duhet të ndërmerr hapa aktivë për të kërkuar nga autoritetet se çfarë hapa, nëse ka, janë duke u ndërmarrë për hetimin e këtij rasti dhe për të raportuar tek autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk janë duke i përmbushur obligimet e veta në atë aspekt;
- vii. Paneli rekomandon që ky vendim duhet t'i jepet organeve përkatëse të Misionit; dhe
- viii. Paneli po ashtu rekomandon që shefi i Misionit duhet të sigurojë se aktivitetet monitoruese të Misionit duhet të zhvillohen në konsistencë me obligimet e Misionit për të drejtat e njeriut dhe se Misioni të sigurojë se kjo pjesë e mandatit të tij i kontribuon mbrojtjes efektive dhe avancimit të atyre të drejtave.

**PANELI ME RESPEKT KËRKON NGA MISIONI** që të raportojë pas zbatimit të këtyre rekomandimeve, sa më parë që është e mundur për Misionin, por jo pas datës 16 mars 2020.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX  
Kryesues

Anna BEDNAREK  
Anëtare



Anna AUTIO  
Anëtare